




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 24 të Ligjit Nr.03/L-për Mbrojtjen e Mjedisit si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR THEMELIMIN E GRUPI PUNUES PËR HARTIMIN E DRAFT-PLANIT LOKAL TË
VEPRIMIT NË MJEDIS

Neni 1
Përbërja

Themelohet Grupi punues për hartimin e Draft-Planit Lokal të Veprimit në Mjedis për Komunën e Lipjanit, në përbërje si vijon:

1. Imri Semetishti, Drejtor i DPUMM, Kryesues
2. Avni Sahiti, Drejtorati për Inspektorat, anëtar
3. Islam Kaleshi Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore, anëtar
4. Hanushe Berisha, DPUMM, anëtare
5. Labinot Dedushi, Drejtorati për Infrastrukturë, anëtar
6. Imri Bytyqi, KRM "Pastrimi" Lipjan, anëtar
7. Bekim Krasniqi, OJQ-YAHR, Lipjan, anëtar
8. Milazim Miftari, Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, anëtar
9. Selman Jashanica, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
10. Hasan Hajdini, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim.

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Grupit punues

Grupi punues ka për detyrë që në pajtim me dispozitat e Ligjit 03/L-25 për Mbrojtjen e Mjedisit, Planit të Kosovës për Veprim në Mjedis si dhe dispozitave të tjera përkatëse të hartojë Propozim - Planin Lokal të Veprimit në Mjedis për Komunën e Lipjanit.

Propozim - Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Komunën e Lipjanit hartohet për periudhën pesë (5) vjeçare 2022 -2027.

Propozim - Plani Lokal i Veprimit në Mjedis duhet të hartohet më së largu me datën 31.08.2022.

Neni 3
Procedimi për miratim i Propozim Planit

Propozim - Planin Lokal të Veprimit në Mjedis, pas hartimit Grupi punues është i obliguar t'ia dërgojë Kryetarit të Komunës për aprovim paraprak e pastaj Propozim – Planit do të vëhet në diskutim publik.

Organizimin e diskutimit publik do ta bëjë Grupi punues i themeluar me këtë Vendim dhe pas mbylljes së fazës së konsultimit publik Propozim Planit nëpërmjet Zyrës së Kryetarit të Komunës do të procedohet për miratim në Kuvendin e Komunës.

Neni 4
Mbështetja profesionale dhe teknike

Grupit Punues sipas nevojës i ofrojnë të dhënat e kërkuara dhe mbështetje tjetër profesionale drejtoratet e caktuara në kuadër të Komunës.

Punët administrativo teknike për grupin punues do t'i kryej Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Neni 5
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin të njoftohen Kryesuesi dhe anëtarët e grupit punues.

01 Nr. 020/oh-16928
Lipjan, më 31.03.2022

